



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

Nr. 16435 Prot

Lezhë, më 25. 08 .2026

Lënda : Dërgim informacioni mbi realizimin e Buxhetit për 7 mujorin e vitit 2026.

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; i ndryshuar, të ligjit nr.68, datë 24. 07.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; i ndryshuar, dhe të Udhëzimit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, bashkëlidhur ju dërgoi informacionin mbi realizimin e buxhetit për 7 mujorin e vitit 2026.

Ju faleminderit për bashkëpunimin Tuaj,

KRYETARI
Pjerin Ndreu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

INFORMACION

MBI REALIZIMIN E BUXHETIT PËR 7 MUJORIN E VITIT 2026

1. Përmbajtja

1.1 Përmbajtja e informacionit (statistika dhe përshkrimet).

2.1 Përshkrimi i përgjithshëm mbi procesin e monitorimit.

3. Formatet e të dhënave

3.1 Raporti i realizimit të të ardhurave vendore;

3.2 Raporti i shpenzimeve sipas programeve dhe funksioneve;

3.3 Raporti i shpenzimeve sipas artikujve buxhetorë;

4. Informacioni shpjegues.

Ky informacion përfshin të dhëna mbi realizimin e buxhetit, në përputhje me kërkesat e udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë nr.22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit”, i ndryshuar, ku në mënyrë të përmbledhur ju informoj:

❖ Realizimi i të ardhurave vendore gjithsej për 7 mujin e vitit 2026 është 74.5% ose 218,100.9 mijë lekë më pak se plani. Realizimi i të ardhurave sipas burimeve të krijimit rezulton si më poshtë;

☞ Të ardhurat nga taksat vendore janë realizuar 65.3% ose 193,113.3 mijë lekë më pak se plani.

☞ Të ardhurat nga taksat e ndara janë realizuar 112.5% ose 5,486.8 mijë lekë më shumë se plani.

☞ Të ardhurat nga tarifat vendore janë realizuar 112.5% ose 23,016.4 mijë lekë më shumë se plani.

☞ Të ardhurat nga shitja e pronës dhe dhënia me qira janë realizuar 29.7% ose 2,329.6 mijë lekë më pak se plani.

☞ Të ardhurat nga burimet e tjera janë realizuar 22.6% ose 51,161.2 mijë lekë më pak

se plani.

☞ Realizimi i të ardhurave në raport me te njëten periudhë të vitit kaluar është 133.7% ose 160,557.1 mijë lekë më shumë të ardhura.

☞ Realizimi i të ardhurave në raport me planin e vitit 2026 është 41.4% ose 899,077.9 mijë lekë më pak se plani.

☞ Arsyet e mosrealizimit të të ardhurave vendore për 7 mujorin e vitit 2026 janë:

☞ Mosrealizimet e të ardhurave nga taksa vendore në shumën 210,570 mijë lekë, të cilat zënë 77.4% të mosrealizimeve gjithsej, ku peshën më të madhe të mosrealizimeve e zë taksa e ndikimit të infrastrukturës nga ndërtimet e reja që përbën peshën kryesore, e cila zë 83.2% të mosrealizimeve të të ardhurave nga taksat vendore dhe 64.4% e mosrealizimeve gjithsej.

☞ Mosrealizimi i të ardhurave nga nga të ardhurat e tjera, e në veçanti të ardhurat nga kontributet (3% për banesat sociale), ka dhënë një ndikim negativ në mosrealizimin e të ardhurave. Mosrealizimi është në masën 49,978.3 mijë lekë, e cili zë rreth 18.4% të mosrealizimeve gjithsej.


☞ Një panoramë të detajuar të realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore jepen në pasqyrën si më poshtë:


REALIZIMI I TË ARDHURAVE PËR 7 MUJORIN E VITIT 2026

Nr	Emërtimi	Fakti 7 Mujor viti 2025	Plani i vitit 2026	Plani 7 Mujor viti 2026	Fakti 7 Mujor viti 2026	Diferenca	
						Në vlerë	Në %
		1	4		5	6	
I	Të ardhurat nga taksat (I/a +I/b)	181,257.1	1,046,000.0	601,234.0	413,607.5	187,626.5	68.8
I/a	Vendore (1-6)	133,180.5	955,500.0	557,363.0	364,249.7	193,113.3	65.3
1	Taksa mbi pasurinë	82,023.1	180,000.0	104,996.0	115,357.0	10,361.0	109.9
1.1	Taksa mbi ndërtesat	50,638.0	110,000.0	64,165.0	69,672.5	5,507.5	108.6
1.2	Taksa mbi tokën bujqësore	4,020.2	10,000.0	5,831.0	13,822.2	7,991.2	237.0
1.3	Taksa mbi truallin	14,919.3	30,000.0	17,500.0	21,424.4	3,924.4	122.4
1.4	Taksa e kalimit drejtës pronësisë P.Palujaj.	12,445.6	30,000.0	17,500.0	10,437.9	7,062.1	59.6
2	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin	200.2	500.0	290.0	178.9	111.1	61.7
3	Taksa ndikimit infrastrukturës nga nd. e reja	42,535.4	700,000.0	408,331.0	233,165.9	175,165.1	57.1
4	Taksa e tabelës dhe reklamës	3,025.5	15,000.0	8,750.0	6,069.2	2,680.8	69.4
5	Taksa e fjetjes në hotele	3,452.2	55,000.0	32,081.0	7,301.5	24,779.5	22.8
6	Taksa të tjera të përkohshme	1,944.1	5,000.0	2,915.0	2,177.2	737.8	74.7
	- Për infrastrukturën në arsim	160.4	0.0	0	91.6	91.6	=
	- Për shtresat në nevojë	1,783.7	5,000.0	2,915.0	2,085.6	829.4	71.5
I/b	E Ndara (1-5)	48,076.6	90,500.0	43,871.0	49,357.8	5,486.8	112.5
1	Taksa vjetore e qarkullimit mjeteve përdorura	32,827.1	55,000.0	32,081.0	33,188.9	1,107.9	103.5
2	Taksa e rentës minerale	144.9	500.0	290.0	325.7	35.7	112.3
3	Tatimi mbi të ardhurat personale	15,104.6	35,000.0	11,500.0	15,834.9	4,334.9	137.7
4	Taksa të tjera	0.0	0.0	0.0	8.3	8.3	=
II	Të Ardhurat Jotatimore (II/a+II/b+II/c)	294,476.9	489,369.0	253,158.0	222,683.6	30,474.4	88.0
II/a	Të ardhurat nga tarifatat vendore	148,144.8	315,000.0	183,720.0	206,736.4	23,016.4	112.5
1	Tarifa e pastrimit & largimit mbetjeve	65,573.9	135,590.0	79,090.0	89,528.8	10,438.8	113.2
2	Tarifë ndriçimi publik	13,176.8	38,000.0	22,161.0	19,397.6	2,763.4	87.5
3	Tarifë gjelbërimi	10,461.5	23,000.0	13,411.0	15,217.8	1,806.8	113.5

4	Tarifa të tjera (licence, leje, autorizime etj.)	517.7	1,400.0	815.0	434.5	380.5	53.3
5	Tarifë parkimi	5,149.4	12,000.0	7,000.0	11,506.5	4,506.5	164.4
6	Tarifë për kulturën	926.7	2,500.0	1,460.0	898.2	561.8	61.5
7	Tarifë për hapësirat publike	34,863.0	60,000.0	35,000.0	38,298.6	3,298.6	109.4
8	Tarifa për shërbimet e Urbanistikës	6,448.2	15,000.0	8,750.0	16,886.0	8,136.0	193.0
9	Tarifë për shërbimet e MZSH	447.0	1,300.0	756.0	932.0	176.0	123.3
10	Tarifë leje transporti	854.1	1,000.0	581.0	1,032.1	451.1	177.6
11	Të ardhura nga tarifa e lëndeve drusore	0.0	500.0	290.0	0.0	290.0	0.0
12	Tarifa tjera për shërbimet administrative	0.0	30.0	15.0	329.2	314.2	21.9 herë
13	Tarifa e shërbimit të ujitjes dhe kullimit	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
14	Tarifa nga pagesat e Çerdhes	2,124.9	5,000.0	2,915.0	1,942.0	973.0	66.6
15	Tarifa nga pagesat e Kopshteve	5,477.6	12,000.0	7,000.0	6,979.4	20.6	99.7
16	Pagesat nga nxënësit (Konvikti Sh.M.Profes.)	151.8	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
17	Tarifa të tjera me vendim Këshilli	1,972.2	7,680.0	4,476.0	3,353.7	1,122.3	74.9
-	Tarifë për dekorin	1,928.6	3,000.0	1,750.0	3,180.0	1,430.0	181.7
-	Tarifë për mirëmbajtjen e varrezave	43.6	2,500.0	1,456.0	173.7	1,282.3	11.9
-	Tarifë për shërbime funerale	0.0	2,180.0	1,270.0	0.0	1,270.0	0.0
II/b	Të ardhura shitja e pronës, dhënia me qira	833.7	5,687.0	3,313.0	983.4	2,329.6	29.7
1	Shitje ndërtesë banimi	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	=
2	Shitje troje	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	=
3	Shitje prona të tjera	0.0	0.0	0.0	24.0	24.0	=
4	Qira mbi trojet	687.4	0.0	0.0	0.0	0.0	=
5	Qira tokë bujqësore	0.0	439.0	254.00	954.5	700.5	3.8 herë
6	Qira mbi ndërtesat ,paisje etj.	146.3	5,248.0	3,059.00	4.9	3,054.1	0.2
II/c	Të ardhura të tjera	145,498.4	168,682.0	66,125.0	14,963.8	51,161.2	22.6
1	Nga dhuratat dhe sponsorizimet etj.	141,034.0	158,182.0	60,000.0	10,021.7	49,978.3	16.7
2	Nga gjrobat	3,543.7	10,500.0	6,125.0	3,895.7	2,229.3	63.6
3	Të ardhura të tjera (debitorë, ankande etj)	920.7	0.0	0.0	1,046.4	1,046.4	=
GJITHSEJ TË ARDHURAT (I + II)		475,734.0	1,535,369.0	854,392.0	636,291.1	218,100.9	74.5

Paraqitja grafike e realizimit të ardhurave gjithsej dhe sipas burimeve në mijë lekë





❖ Realizimi i shpenzimeve me burimet e veta të bashkisë për 7 mujorin e vitit 2026 është 52.8% ose 879,093.9 mijë lekë më pak se plani.

☞ Realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është 77.3% ose 156,305.4 mijë lekë më pak se plani.

☞ Realizimi i shpenzimeve të tjera korrente është 49.1% ose 205,142.3 mijë lekë më pak se plani.

☞ Realizimi i shpenzimeve kapitale (investimet) është 32.9% ose 517,646.2 mijë lekë më pak se plani.

☞ Ndër faktorët që ka ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve të parashikuara është mosrealizimi i të ardhurave vendore të planifikuara për 7 mujorin e vitit 2026.

☞ Faktor tjetër që ka ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve është numri më vogël i punonjësve në raport me planin.

☞ Fondet sektoriale të trashëguara nga viti 2025, kryesisht ato për paga dhe sigurime shoqërore, nuk janë përdorur gjatë kësaj periudhe të vitit 2026.

☞ Në mosrealizimin e shpenzimeve kanë ndikuar edhe disa faktorë të tjerë, si mosdepozitimi në kohë i dokumentave justifikues për kryerjen e investimeve apo shërbimeve, pavarësisht se ato janë kryer në fakt, si dhe shtyerja e afateve të procedurave të prokurimit, si shkak i ndryshimeve buxhetore gjatë kësaj periudhe.

- Realizimi shpenzimeve sipas programeve buxhetore dhe funksioneve paraqiten:

SHPENZIMET SIPAS PROGRAMEVE DHE FUNKSIONEVE PËR 7 MUJORIN E VITIT 2026

Programet/Funksionet		Shpenzimet në mijë lekë				
Prog.	Emërtimi	Fakti 7 M viti 2025	Plani 7 M viti 2026	Fakti 7 M viti 2026	Realizimi	
					Në vlerë	Në %
AA127	Planifikim, menaxhim dhe administrim	124,153.9	154,549.5	131,961.7	22,587.8	85.4
	Çështje financiare dhe fiskale	22,131.5	23,618.3	18,500.6	5,117.7	78.3
	Pagesa e shërbimit të borxhit	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Marrëdhëniet në komunitet	0.0	100.9	0.0	100.9	0.0

	Planifikimi urban vendor	22,013.9	21,869.9	19,410.0	2,459.9	88.7
1	<i>Shërbimet Administrative, Menaxheriale</i>	168,299.3	200,138.6	169,872.3	30,266.3	84.9
AB127	Shërbimet e policisë vendore	14,217.6	11,368.8	9,106.4	2,262.4	80.1
	Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi	38,284.6	67,420.1	35,412.3	32,007.8	52.5
	Emergjencat civile	14,741.9	40,961.5	18,264.5	22,697.0	44.6
2	<i>Rendi dhe Siguria Publike</i>	67,244.1	119,750.4	62,783.2	56,967.2	52.4
AC127	Mbështetja për zhvillimin ekonomik	195.0	65.6	0.00	65.6	0.0
	Shërbimi i tregjeve dhe inspektimi	5,009.6	5,776.3	4,956.2	820.1	85.8
	Shërbimet bujqësore, siguria ushqimore etj.	11,764.5	13,702.0	11,785.7	1,916.2	86.0
	Menaxhimi infrastrukturës ujitjes/kullimit	24,271.1	82,250.6	31,181.2	51,069.4	37.9
	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	20,842.4	28,279.1	23,149.0	5,130.1	81.9
3	<i>Çështjet e Përgjithshme Ekonomike</i>	62,082.6	130,073.6	71,072.1	59,001.5	54.6
AD127	Rrjeti rrugor rural	8,273.4	156,930.7	48,993.2	107,937.5	31.2
	Menaxhimi i mbetjeve	65,342.6	188,641.9	110,656.0	77,985.9	58.7
	Ndërgjegjësimi mjedisor	877.4	1,702.8	1,558.8	144.0	91.5
	Shërbimet publike vendore	67,078.0	504,856.8	189,691.5	315,165.3	37.6
	Furnizimi me ujë dhe kanalizime	23,194.3	7,048.5	4,675.3	2,373.2	66.3
	Ndriçimi i rrugor	11,519.3	49,825.3	38,361.5	11,463.8	77.0
4	<i>Infrastruktura, Mjedisi e Shërb.Publike</i>	176,285.0	909,006.0	393,936.3	515,069.7	43.3
AE127	Zhvillimi i Turizmit	9,261.3	9,246.5	6,348.5	2,898.0	68.7
	Trashëgimia kulturore, muzeu e biblioteka	10,841.1	21,130.5	13,201.3	7,929.2	62.5
	Arti dhe kultura	19,620.1	16,256.0	11,337.5	4,918.5	69.7
5	<i>Turizmi dhe Kultura</i>	39,722.5	46,633.0	30,887.3	15,745.7	66.2
AF127	Sport dhe argëtim	17,506.7	23,720.9	22,375.3	1,345.6	94.3
	Arsimi parashkollor dhe arsimi bazë	128,219.7	288,322.3	145,548.1	142,774.2	50.5
	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	23,531.9	52,259.8	25,381.8	26,878.0	48.6
6	<i>Arsimi, Rinia dhe Sporti</i>	169,258.3	364,303.0	193,305.2	170,997.8	53.1
AG127	Kujdesi social për PAK	13,298.7	17,769.7	14,957.8	2,811.9	84.2
	Përkujdesja sociale për familje dhe fëmijë	25,589.9	34,089.7	25,228.9	8,860.8	74.0
	Strehimi social	931.0	34,721.5	20,361.8	14,359.7	58.6
7	<i>Përkujdesja Sociale dhe Strehimi</i>	39,819.6	86,580.9	60,548.5	26,032.4	69.9
AH127	Fondi Rezervë	0.0	5,013.3	0.00	5,013.3	0.0
	Fondi i Kontigjencës	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
8	<i>Fondi Rezervë dhe i Kontigjencës</i>	0.0	5,013.3	0.0	5,013.3	0.0
T O T A L I (1 – 8)		722,711.4	1,861,498.8	982,404.9	879,093.9	52.8

Duke parë realizimin e shpenzimeve në tabelën e mësipërme rezulton se të gjitha programe rezultojnë me mosrealizime si:

*Programi “AA127”, “Shërbimet administrative dhe menaxheriale”, mosrealizimi ka ardhur kryesisht për arsye të mungesës së dokumentacionit justifikues për likuidimin e shpenzimeve për mallra, shërbime dhe investime, dhe numrit më të vogël të punonjësve në raport me plani.

*Programi “AB127” “Rendi dhe Siguria Publike”, mosrealizimi ka ardhur kryesisht për arsye të mospërdorimit të fondeve për emergjencat civile, në raport me parashikimin, nga mospërdorimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore, me burim financi-

mi nga transferta sektoriale, si dhe nga mospërdorimi në afat i fondit të investimeve, për arsye të mungesës së dokumentacionit justifikues për likuidimin e shpenzimeve.

*Programi “AC127” “Çështjet e Përgjithshme Ekonomike”, mosrealizimi ka ardhur si rezultat i mosshlyerjes së shpenzimeve për mallra, shërbime dhe investime, për arsye të mungesës së dokumentacionit justifikues për likuidimin e tyre.

*Programi “AD127” “Infrastruktura, Mjedisi dhe Shërbimet Publike”, mosrealizimi ka ardhur si rezultat i moslikuidimi në afat i shpenzimeve për mallra, shërbime dhe investime, për mosparaqitje në afat të dokumenteve justifikues dhe faturave për likuidim.


*Programi “AE127” “Turizmi dhe Kultura”, mosrealizimi ka ardhur kryesisht si rezultat i moslikuidimit të shpenzimeve për mallra, shërbime dhe investime, për mosparaqitje në afat të faturave për likuidim.

*Programi “AF127” “Arsimi, Rinia dhe Sporti”, mosrealizimi ka ardhur si rezultat i moslikuidimit të shpenzimeve për mallra, shërbime dhe investime, për mosparaqitje në afat të faturave për likuidim, si dhe nga mospërdorimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore, me burim financimi nga transferta sektoriale, të trasheguara nga viti 2025.

*Programi “AG127” “Përkujdesja Sociale dhe Strehimi”, mosrealizimi ka ardhur kryesisht si rezultat i moslikuidimit të shpenzimeve për mallra, shërbime dhe investime, për mosparaqitje në afat të faturave për likuidim.

*Programi “AH127” “Rezervat”, mosrealizimi ka ardhur si rezultat i mosparaqitjes së kërkesave për përdorim të këtyre fondeve.

Realizimi i shpenzimet sipas programeve (në mijë lekë)



- Raporti i shpenzimeve buxhetore sipas fushave kryesore është si më poshtë:

☞ Shpenzimet për Shërbimet e Përgjithshme Publike janë realizuar 84.4% ose 27,705.5 mijë lekë më pak se plani. Shpenzimet për këtë fushë zënë 15.3% të shpenzimeve gjithsej në fakt.

☞ Shpenzimet për Rendin dhe Sigurinë Publike janë realizuar 56.4% ose 34,371.1 mijë

lekë më pak se plani. Shpenzimet për këtë fushë zënë 4.5% të shpenzimeve gjithsej në fakt.

☞ Shpenzimet për Çështjet Ekonomike janë realizuar 42% ose 174,850.3 mijë lekë më pak se plani. Shpenzimet për këtë fushë zënë 12.9% të shpenzimeve gjithsej në fakt.

☞ Shpenzimet për Mbrojtjen e Mjedisit janë realizuar 59% ose 78,129.9 mijë lekë më pak se plani. Shpenzimet për këtë fushë zënë 11.4% të shpenzimeve gjithsej në fakt.

☞ Shpenzimet për Strehimin dhe Komunitetin janë realizuar 43.2% ose 331,462.2 mijë lekë më pak se plani. Shpenzimet për këtë fushë zënë 25.7% të shpenzimeve gjithsej në fakt.


☞ Shpenzimet për Argëtim dhe Kulturë janë realizuar 76.8% ose 14,193.3 mijë lekë më pak se plani. Shpenzimet për këtë fushë zënë 4.8% të shpenzimeve gjithsej në fakt.

☞ Shpenzimet për Arsimin janë realizuar 50.2% ose 169,652.2 mijë lekë më pak se plani. Shpenzimet për këtë fushë zënë 17.4% të shpenzimeve gjithsej në fakt.

☞ Shpenzimet për Mbrojtjen Sociale janë realizuar 61.8% ose 48,729.4 mijë lekë më pak se plani. Shpenzimet për këtë fushë zënë 8% të shpenzimeve gjithsej në fakt.

Paraqitja grafike e realizimit të shpenzimeve sipas fushave kryesore

Në mijë lekë



- Realizimi i shpenzimeve gjithsej sipas strukturës ekonomike paraqitet:

RAPORTI I SHPENZIMEVE SIPAS STRUKTURËS EKONOMIKE PËR 7 MUJORIN E VITIT 2026


Në 000/lekë

Art.	Emërtimi	Fakti 7 M viti 2025	Plani 7 M viti 2026	Fakti 7 M viti 2026	Realizimi	
					Në vlerë	Në %
600	Paga	394,641.5	589,558.6	455,487.1	134,071.5	77.3
601	Sigurime Shoqërore	65,433.8	98,048.6	75,814.7	22,233.9	77.3
602	Mallra dhe Shërbime të tjera	154,770.5	296,832.1	156,270.1	140,562.0	52.6
603	Subvencione					
604	Transferta Korrente të brendshme	16,267.4	20,785.0	20,688.2	96.8	99.5
605	Transferta Korrente të huaja					


606	Transferta për Buxh.Fam.& Individ	17,707.9	80,235.9	20,765.7	59,470.2	25.9
609	Rezervat	0.0	5,013.3	0.0	5,013.3	0.0
Nën-Totali	Shpenzimet Korrente	648,821.1	1,090,473.5	729,025.8	361,447.7	66.9
230	Kapitale të Patrupëzuara	1,992.0	4,225.0	500.0	3,725.0	11.8
231	Kapitale të Trupëzuara	71,898.3	763,578.1	252,879.1	510,699.0	33.1
232	Transferta Kapitale					
Nën-Totali	Shpenzime Kapitale me Fin.Brend.	73,890.3	767,803.1	253,379.1	514,424.0	33.0
230	Kapitale të Patrupëzuara					
231	Kapitale të Trupëzuara		3,222.2	0.0	3,222.2	0.0
232	Transferta Kapitale					
Nën-Totali	Shpenzime Kapitale me Finan.Huaj	0.0	3,222.2	0.0	3,222.2	0.0
Totali	Shpenzime Kapitale	73,890.3	771,025.3	253,379.1	517,646.2	32.9
Totali Korente + Kapitale		722,711.4	1,861,498.8	982,404.9	879,093.9	52.8

Paraqitja grafike e shpenzimeve sipas strukturës ekonomike

Në mijë lekë



Paraqitja grafike e shpenzimeve sipas strukturës ekonomike në %



Referuar të dhënave të mësipërme rezulton se realizimi i buxhetit sipas strukturës ekonomike është si më poshtë;

☞ Shpenzimet për paga janë realizuar 77.3% ose 130,071.5 mijë lekë më pak se plani.

☞ Shpenzimet për sigurimet shoqërore janë realizuar 77.3% ose 22,233.9 mijë lekë më pak se plani.

Mosrealizimet e shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore kanë ardhur si rezultat i numrit më të ulët të punonjësve në raport me parashikimin, si dhe nga shtimi i planit 7 mujor me fondet e trasheguara nga viti 2025 për paga e sigurime shoqërore.

☞ Shpenzimet për mallra e shërbime janë realizuar 52.6% ose 140,562 mijë lekë më pak se plani.

☞ Shpenzimet nga transferta e brendshme janë realizuar 99.5% ose 96.8 mijë lekë më pak se plani.

☞ Shpenzimet për buxhetin e familjeve dhe individëve janë realizuar 25.9% ose 59,470.2 mijë lekë më pak se plani.

☞ Shpenzimet (Rezervat) janë papërdorur në shumën 5,013.3 mijë lekë.

☞ Shpenzimet për investime kapitale janë realizuar 32.9% ose 517,646.2 mijë lekë më pak se plani.

- Shkaqet e mosrealizimeve të shpenzimeve janë:

✗ Mosrealizimi i të ardhurave të parashikuara.

✗ Moslikujdimi në afat i shpenzimeve për mallra, shërbime dhe investime të realizuara (për arsye të mosparaqitjes të dokumentacionit përkatës dhe faturave për likujdim).

Realizimi i shpenzimeve sipas strukturës (korrente dhe kapitale) dhe përqindjes që zënë në totalin e buxhetit është;

☞ Shpenzimet korrente janë realizuar 66.9% ose 361,447.7 mijë lekë më pak se plani, shpenzime të cilat zënë 74.2% të totalit të shpenzimeve në fakt. Nga këto: shpenzimet për paga zënë 46.4% të totalit të shpenzimeve buxhetore; shpenzimet për sigurimet shoqërore zënë 7.7% të totalit të shpenzimeve buxhetore; shpenzimet për mallra dhe shërbime zënë 15.9% të totalit të shpenzimeve buxhetore; shpenzimet për transfertat e brendshme zënë 2.1% të totalit të shpenzimeve buxhetore; shpenzimet për buxhetin e familjeve dhe individëve zënë 2.1%, të totalit të shpenzimeve buxhetore në fakt.

☞ Shpenzimet kapitale janë realizuar 32.9% ose 517,646.2 mijë lekë më pak se plani. Këto shpenzime zënë 25.8% të totalit të shpenzimeve buxhetore në fakt.

☛ Referuar të dhënave mësipërme rezulton se mosrealizimi i shpenzimeve korrente zënë 41.1% dhe i shpenzimeve kapitale zënë 58.9% të mosrealizimeve gjithsej.

- Realizimi i shpenzimeve me fondet e kushtëzuar sipas strukturës ekonomike.


RAPORTI I SHPENZIMEVE SIPAS STRUKTURËS EKONOMIKE PËR 7 MUJORIN E VITIT 2026

Art.	Emërtimi	Fakti 7 M viti 2025	Plani 7 M viti 2026	Fakti 7 M viti 2026	Në 000/lekë	
					Realizimi	
					Në vlerë	Në %
600	Paga	8,275.7	8,508.0	8,503.0	5.0	99.9
601	Sigurime Shoqërore	1,381.3	1,440.0	1,396.8	43.2	97.0
602	Mallra dhe Shërbime të tjera	3,972.2	21,227.5	5,197.2	16,030.3	24.5
603	Subvencione					

604	Transferta Korrente të brendshme	1,982.8	2,800.0	1,093.7	1,706.3	39.1
606	Transferta për Buxh.Fam.& Individ	342,832.8	750,185.6	364,125.8	386,059.8	48.5
Nën-Totali	Shpenzimet Korrente	358,444.8	784,161.1	380,316.5	403,844.6	48.5
230	Kapitale të Patrupëzuara	0.0	2,175.0	0.0	2,175.0	0.0
231	Kapitale të Trupëzuara	127,689.2	142,131.4	88,942.9	53,188.5	62.6
232	Transferta Kapitale					
Nën-Totali	Shpenzime Kapitale me Fin.Brend.	127,689.2	144,306.4	88,942.9	55,363.5	61.6
230	Kapitale të Patrupëzuara					
231	Kapitale të Trupëzuara					
232	Transferta Kapitale					
Nën-Totali	Shpenzime Kapitale me Finan.Huaj	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Totali	Shpenzime Kapitale	127,689.2	144,306.4	88,942.9	55,363.5	61.6
Totali Korente + Kapitale		486,134.0	928,467.5	469,259.4	459,208.1	50.5

Paraqitja grafike e shpenzimeve sipas strukturës ekonomike

Në mijë lekë



Referuar të dhënave të mësipërme rezulton se realizimi i buxhetit me fondet e kushtëzuara, sipas strukturës ekonomike është si më poshtë;

- ☞ Shpenzimet për paga janë realizuar 99.9% ose 5 mijë lekë më pak se plani.
- ☞ Shpenzimet për sigurimet shoqërore janë realizuar 97% ose 43.2 mijë lekë më pak se plani.
- ☞ Shpenzimet për mallra e shërbime janë realizuar 24.5% ose 16,030.3 mijë lekë më pak se plani. Ky mosrealizim, ka ardhur kryesisht nga mospërdorimi i fondit të trasheguar nga viti 2025, për shëmbjen e banesave individuale të dëmtuara nga termeti.
- ☞ Shpenzimet për transfertat e brendshme janë realizuar 39.1% ose 1,706.3 mijë lekë më pak se plani.
- ☞ Shpenzimet për buxhetin e familjeve dhe individëve janë realizuar 48.5% ose 386,059.8 mijë lekë më pak se plani. Mosrealizimi ka ardhur nga mospërdorimi i fondeve të akorduar për rindërtimin e banesave individuale të dëmtuara nga termeti i vitit 2019.
- ☞ Shpenzimet për investime kapitale janë realizuar 61.6% ose 55,363.5 mijë lekë më pak se plani. Mosrealizimi ka ardhur kryesisht nga mospërdorimi i fondeve të akorduar për rindërtimin e banesave në bashkëpronësi të dëmtuara nga termeti i vitit 2019, nga

mospërdorimi i fondit të akorduar për emergjencat civile në shumën 22,631.1 mijë lekë, si dhe nga mospërdorimi i fondit prej 10,000 mijë lekë për rikonstruksimin e kanalit të ujitës Kotërr-Kakarriq.

➡Referuar të dhënave mësipërme rezulton se mosrealizimi i shpenzimeve korrente zënë 87.9% dhe i shpenzimeve kapitale zënë 12.1% të mosrealizimeve gjithsej.

DREJTORI I FINANCËS DHE BUXHETIT

Mariolina Lleshi



REALIZIMI I TË ARDHURAVE VENDORE PËR PERIUDHËN JANAR-KORRIK 2026

Në mijë lekë

Njësia Vendore		BASHKIA LEZHË		Kodi Grupit		127	
Të Ardhurat Vendore							
Nr	Emërtimi	Fakti 7 mujor viti 2025	Buxheti Plani i vitit 2026	Buxheti Plani i Rishikuar viti 2026	Buxheti Plani 7 mujor viti 2026	Buxheti Fakti 7 mujor viti 2026	Diferenca Në vlerë Në %
		1	2	3	4	5	6
I	Të ardhurat nga taksat (I/a +I/b)	181,257.1	1,046,000.0	1,046,000.0	601,234.0	413,607.5	187,626.5
I/a	Vendore (1-6)	133,180.5	955,500.0	955,500.0	557,363.0	364,249.7	193,113.3
1	Taksa mbi pasurinë	82,023.1	180,000.0	180,000.0	104,996.0	115,357.0	109.9
1.1	Taksa mbi ndërtesat	50,638.0	110,000.0	110,000.0	64,165.0	69,672.5	108.6
1.2	Taksa mbi tokën bujqësore	4,020.2	10,000.0	10,000.0	5,831.0	13,822.2	237.0
1.3	Taksa mbi truallin	14,919.3	30,000.0	30,000.0	17,500.0	21,424.4	122.4
1.4	Taksa e kalimit të drejtës pronësisë Pas.Paluaajtshme	12,445.6	30,000.0	30,000.0	17,500.0	10,437.9	59.6
2	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin	200.2	500.0	500.0	290.0	178.9	61.7
3	Taksa e ndikimit të infrastrukturës nga ndërtimet e reja	42,535.4	700,000.0	700,000.0	408,331.0	233,165.9	57.1
4	Taksa e tabelës dhe reklamës	3,025.5	15,000.0	15,000.0	8,750.0	6,069.2	69.4
5	Taksa e fjetjes në hotele	3,452.2	55,000.0	55,000.0	32,081.0	7,301.5	22.8
6	Taksa të tjera të përkohshme	1,944.1	5,000.0	5,000.0	2,915.0	2,177.2	74.7
	-Për infrastrukturën në arsim	160.4	0.0	0.0	0	91.6	=
	-Për shtresat në nevojë	1,783.7	5,000.0	5,000.0	2,915.0	2,085.6	71.5
I/b	E Ndara (1-5)	48,076.6	90,500.0	90,500.0	43,871.0	49,357.8	5,486.8
1	Taksa e regjistrimit të automjeteve	32,827.1	55,000.0	55,000.0	32,081.0	33,188.9	103.5
2	Taksa e rentës minerale	144.9	500.0	500.0	290.0	325.7	112.3
3	Tatimi mbi të ardhurat personale	15,104.6	35,000.0	35,000.0	11,500.0	15,834.9	137.7
4	Taksa të tjera	0.0	0.0	0.0	0.0	8.3	=
II	Të Ardhurat Jotatimore (II/a + II/b + II/c)	294,476.9	489,369.0	489,369.0	253,158.0	222,683.6	30,474.4
II/a	Të ardhurat nga tarifatat vendore	148,144.8	315,000.0	315,000.0	183,720.0	206,736.4	23,016.4
1	Tarifa e pastrimit & largimit mbetjeje	65,573.9	135,590.0	135,590.0	79,090.0	89,528.8	113.2
2	Tarifë ndriçimi publik	13,176.8	38,000.0	38,000.0	22,161.0	19,397.6	87.5
3	Tarifë gjelbërimi	10,461.5	23,000.0	23,000.0	13,411.0	15,217.8	113.5
4	Tarifë shërbimi veterinar	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	=
5	Tarifa të tjera (licenca, leje, autorizime, etj.)	517.7	1,400.0	1,400.0	815.0	434.5	53.3
6	Tarifë parkimi	5,149.4	12,000.0	12,000.0	7,000.0	11,506.5	164.4

7	Tarifë për kulturën	926.7	2,500.0	2,500.0	1,460.0	898.2	561.8	61.5
8	Tarifë për hapësirat publike	34,863.0	60,000.0	60,000.0	35,000.0	38,298.6	3,298.6	109.4
9	Të ardhura nga tarifë e Urbanistikës	6,448.2	15,000.0	15,000.0	8,750.0	16,886.0	8,136.0	193.0
10	Tarifë për shërbimet e MZSH	447.0	1,300.0	1,300.0	756.0	932.0	176.0	123.3
11	Tarifë leje transporti	854.1	1,000.0	1,000.0	581.0	1,032.1	451.1	177.6
12	Të ardhura nga tarifa për pyjet dhe kullotat	0.0	500.0	500.0	290.0	0.0	290.0	0.0
13	Tarifa tjera për shërbimet administrative	0.0	30.0	30.0	15.0	329.2	314.2	21.9 herë
14	Tarifa e shërbimit të ujitjes dhe kullimit	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	=
15	Pagesat nga Çerdhet	2,124.9	5,000.0	5,000.0	2,915.0	1,942.0	973.0	66.6
16	Pagesat nga Kopshtet	5,477.6	12,000.0	12,000.0	7,000.0	6,979.4	20.6	99.7
17	Pagesat nga nxënësit e Konviktit të Sh.M.Profesionale	151.8	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	=
18	Tarifa të tjera	1,972.2	7,680.0	7,680.0	4,476.0	3,353.7	1,122.3	74.9
-	Tarifë për dekorin	1,928.6	3,000.0	3,000.0	1,750.0	3,180.0	1,430.0	181.7
-	Tarifë për mirëmbajtjen e varrezave	43.6	2,500.0	2,500.0	1,456.0	173.7	1,282.3	11.9
-	Tarifë për shërbime funerale		2,180.0	2,180.0	1,270.0	0.0	1,270.0	0.0
II/b	Të ardhura nga shitja e pronës dhe dhënia me qira	833.7	5,687.0	5,687.0	3,313.0	983.4	2,329.6	29.7
1	Shitje ndërtesa banimi	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	=
2	Shitje troje	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	=
3	Shitje prona të tjera (automjete për skrap dhe inv.ek.)	0.0	0.0	0.0	0.0	24.0	24.0	=
4	Qira mbi trojet	687.4	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	=
5	Qira tokë bujqësore dhe pyje	0.0	439.0	439.0	254.00	954.5	700.5	3.8 herë
6	Qira mbi ndërtesat ,pajisje etj.	146.3	5,248.0	5,248.0	3,059.00	4.9	3,054.1	0.2
II/c	Të ardhura të tjera	145,498.4	168,682.0	168,682.0	66,125.0	14,963.8	51,161.2	22.4
1	Nga kontributet, dhuratat dhe sponsorizimet etj.	141,034.0	158,182.0	158,182.0	60,000.0	10,021.7	49,978.3	16.7
2	Nga gjobat	3,543.7	10,500.0	10,500.0	6,125.0	3,895.7	2,229.3	63.6
3	Të ardhura të tjera (debitorë / kamatëvonesa, etj)	920.7	0.0	0.0	0.0	1,046.4	1,046.4	=
GJITHSEJ TË ARDHURAT (I + II)		475,734.0	1,535,369.0	1,535,369.0	854,392.0	636,291.1	218,100.9	74.5

RAPORTI I SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE DHE FUNKSIONEVE PËR PERIUDHËN JANAR-KORRIK 2026

Në 000/lekë

Emri i Grupit		Bashkia Lezhë				Kodi i Grupit		127
Programet / Funksionet		Shpenzimet e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore						
Titulli	Emërtimi	(1) Buxheti Fakti 7 mujori viti 2025	(2) Buxheti PBA viti 2026	(3) Buxheti Plani viti 2026	(4) Buxheti Plani i Rishikuar viti 2026	(5) Buxheti Plani 7 mujori viti 2026	(6) Buxheti Fakti 7 mujori viti 2026	(7 = (6-5) Diferenca (7 = 6 – 5)
01110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	124,153.9	234,144.0	234,144.0	240,771.4	154,549.5	131,961.7	22,587.8
01120	Çështje financiare dhe fiskale	22,131.5	37,864.0	37,864.0	38,836.9	23,618.3	18,500.6	5,117.7
01710	Pagesa e shërbimit të borxhit	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
03600	Marrëdhëniet në komunitet	0.0	173.0	173.0	293.0	100.9	0.0	100.9
06140	Planifikimi urban vendor	22,013.9	45,037.0	45,037.0	36,138.0	21,869.9	19,410.0	2,459.9
I	Programi AA127	168,299.3	317,218.0	317,218.0	316,039.3	200,138.6	169,872.3	30,266.3
03140	Shërbimet e policisë vendore	14,217.6	18,209.7	18,209.7	18,312.3	11,368.8	9,106.4	2,262.4
03280	Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi	38,284.6	67,183.2	67,183.2	97,557.2	67,420.1	35,412.3	32,007.8
10910	Emergjencat civile	14,741.9	59,569.0	59,569.0	81,543.3	40,961.5	18,264.5	22,697.0
2	Programi AB127	67,244.1	144,961.9	144,961.9	197,412.8	119,750.4	62,783.2	56,967.2
04130	Mbështetja për zhvillimin ekonomik	195.0	5,112.5	5,112.5	112.5	65.6	0.00	65.6
04160	Shërbimi i tregjeve dhe inspektimi	5,009.6	9,233.5	9,233.5	9,395.7	5,776.3	4,956.2	820.1
04220	Shërbimet bujqësore,sig.ushqimore etj.	11,764.5	22,102.0	22,102.0	23,085.0	13,702.0	11,785.7	1,916.2
04240	Menaxhimi infrastrukturës ujitjes e kullimit	24,271.1	95,877.4	95,877.4	149,019.2	82,250.6	31,181.2	51,069.4
04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	20,842.4	45,099.2	45,099.2	66,864.3	28,279.1	23,149.0	5,130.1
3	Programi AC127	62,082.6	177,424.6	177,424.6	248,476.7	130,073.6	71,072.1	59,001.5
04520	Rrjeti rrugor rural	8,273.4	425,060.0	425,060.0	466,478.8	156,930.7	48,993.2	107,937.5
05100	Menaxhimi i mbetjeve	65,342.6	202,668.0	202,668.0	280,503.1	188,641.9	110,656.0	77,985.9
05630	Ndërgjegjësimi mjedisor	877.4	2,722.0	2,722.0	2,851.2	1,702.8	1,558.8	144.0
06260	Shërbimet publike vendore	67,078.0	577,628.0	577,628.0	689,370.0	504,856.8	189,691.5	315,165.3
06370	Furnizimi me ujë dhe kanalizime	23,194.3	11,387.0	11,387.0	11,210.3	7,048.5	4,675.3	2,373.2
06440	Ndriçimi i rrugor	11,519.3	45,554.0	45,554.0	70,875.5	49,825.3	38,361.5	11,463.8
4	Programi AD127	176,285.0	1,265,010.0	1,265,010.0	1,521,288.9	909,006.0	393,936.3	515,069.7
04760	Zhvillimi i Turizmit	9,261.3	15,285.0	15,285.0	18,032.8	9,246.5	6,348.5	2,898.0
08220	Trashëgimia kulturore,muzeu e biblioteka	10,841.1	31,399.0	31,399.0	33,399.9	21,130.5	13,201.3	7,929.2
08230	Arti dhe kultura	19,620.1	25,476.0	25,476.0	26,402.7	16,256.0	11,337.5	4,918.5

5	Programi AE127	39,722.5	72,160.0	72,160.0	77,835.4	46,633.0	30,887.3	15,745.7
08130	Sport dhe argëtim	17,506.7	34,825.0	34,825.0	39,275.2	23,720.9	22,375.3	1,345.6
09120	Arsimi parashkollor dhe arsimi bazë	128,219.7	245,578.9	245,578.9	434,282.8	288,322.3	145,548.1	142,774.2
09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	23,531.9	47,713.0	47,713.0	72,226.7	52,259.8	25,381.8	26,878.0
6	Programi AF127	169,258.3	408,533.0	408,533.0	545,784.7	364,303.0	193,305.2	170,997.8
10140	Kujdesi social për PAK	13,298.7	28,599.0	28,599.0	29,765.6	17,769.7	14,957.8	2,811.9
10430	Përkujdesja sociale për familje dhe fëmijë	25,589.9	42,217.0	42,217.0	56,882.2	34,089.7	25,228.9	8,860.8
10661	Strehimi social	931.0	8,746.0	8,746.0	91,957.4	34,721.5	20,361.8	14,359.7
7	Programi AG127	39,819.6	103,538.0	103,538.0	178,605.2	86,580.9	60,548.5	26,032.4
04910	Fondi Rezervë	0.0	8,000.0	8,000.0	8,000.0	5,013.3	0.00	5,013.3
04940	Fondi i Kontigjencës	0.0	8,000.0	8,000.0	0.0	0.0	0.0	0.0
8	Programi AH127	0.0	16,000.0	16,000.0	8,000.0	5,013.3	0.0	5,013.3
TOTAL I (1 - 8)		722,711.4	2,504,845.5	2,504,845.5	3,093,443.0	1,861,498.8	982,404.9	879,093.9

RAPORTI I SHPENZIMEVE TË PROGRAMEVE SIPAS ARTIKUJVE PËR PERIUDHËN JANAR-KORRIK 2026

Në 000/lekë

Bashkia	Lezhë							Kodi i Grupit	127
Programi	Përmbledhëse							Kod Programi	00
Art.	Emërtimi	(1) Buxheti Fakti 7 mujori viti 2025	(2) Buxheti PBA viti 2026	(3) Buxheti Plani viti 2026	(4) Buxheti Plani i Rishikuar viti 2026	(5) Buxheti Plani 7 mujori viti 2026	(6) Buxheti Fakti 7 mujori viti 2026	(7 = (6-5) Diferenca (7 = 6 – 5)	
600	Paga	394,641.5	827,557.4	827,557.4	913,466.0	589,558.6	455,487.1	134,071.5	
601	Sigurime Shoqërore	65,433.8	137,826.6	137,826.6	151,632.2	98,048.6	75,814.7	22,233.9	
602	Mallra dhe Shërbime të tjera	154,770.5	479,686.4	479,686.4	503,770.0	296,832.1	156,270.1	140,562.0	
603	Subvencione								
604	Transferta Korente të brendshme	16,267.4	31,220.0	31,220.0	35,185.0	20,785.0	20,688.2	96.8	
605	Transferta Korente të huaja								
606	Transferta për Buxh.Fam.& Individ	17,707.9	104,969.1	104,969.1	138,138.4	80,235.9	20,765.7	59,470.2	
609	Fondi Rezervë dhe i Kontigjencës	0.0	16,000.0	16,000.0	8,000.0	5,013.3	0.0	5,013.3	
166-651	Hua-marrja dhe interesa	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
Nën-Totali	Shpenzimet Korente	648,821.1	1,597,259.5	1,597,259.5	1,750,191.6	1,090,473.5	729,025.8	361,447.7	
230	Kapitale të Trupëzuara	1,992.0	15,840.0	15,840.0	19,652.3	4,225.0	500.0	3,725.0	
231	Kapitale të Trupëzuara	71,898.3	891,746.0	891,746.0	1,320,376.9	763,578.1	252,879.1	510,699.0	
232	Transferta Kapitale								
